

PRIVATIZIMI DHE EFIKASITETI I TIJ
NË SHQIPËRI

Fatmir Mema

Saimir Sallaku

Pedagog në Fakultetin Ekonomik

Asistent në Fakultetin Ekonomik

HYRJE

Në procesin e transformimit të ekonomisë theksi vihet tek reformat strukturore ku një ndër shtyllat mbështetëse të këtyre reformave është edhe procesi i privatizimit. Në këtë proces zakonisht objektivat politikë ecin (më mirë të themi fluturojnë) me ritme mjaft të shpejta ndërkohë që, ana ekonomike përpiqet të ecë më ngadalë për të gabuar më pak dhe për të kundërshtuar fluturimet e pabazuara politike.

Por, nëse shtrojmë pyetjen se çfarë po ndodh me ndërmarrjet e privatizuara dhe a janë arritur objektivat e pasprivatizimit duhet të pranojmë se është e vështirë që të gjenden të dhënat për të bërë një analizë të plotë me qëllim dhënien e një përgjigjeje të saktë. Megjithatë, në hapësirën e ngushtë të këtij materiali, ne do të përpiqemi të trajtojmë disa momente kryesore.

1. PËRDORIMI I BONOVE TË PRIVATIZIMIT DHE BESIMI I PUBLIKUT NË TO

Së pari, duhet të theksojmë se bonot e privatizimit, si letra me vlerë të përdorshme vetëm gjatë procesit të privatizimit, janë dhe mbeten letra me vlerë dhe duhen trajtuar si të tilla.

Por, fatkeqësisht, në periudhën e parë pas emetimit (megjithë propagandën e madhe) ato shërbyen vetëm si një mjet për përfitim të grupeve të caktuara, shpesh edhe në mënyrë korruptive, dhe për pasojë në procesin e privatizimit masiv u përdorën vetëm një pjesë e vogël e tyre (14.59 për qind e totalit ose 21.35 për qind e bonove të privatizimit të shpërndara).

Bazuar në strategjinë e privatizimit edhe në privatizimin strategjik po përdoren, gjithashtu, një pjesë fare e vogël e tyre duke bërë që për shumicën e shqiptarëve ato të kthehen në letra pa vlerë. Pra, ka munguar dhe mungon një politikë e caktuar qeveritare në këtë drejtim.

Në këndvështrimin tonë problemi duhet të trajtohet kështu:

Së pari, ato janë letra me vlerë të emetuara nga Qeveria Shqiptare dhe si të tilla duhet të përbëjnë një detyrim për çdo qeveri shqiptare, që është ose do të vijë në fuqi. Këtu nuk kemi hapësirë të japim detaje, por duhet të theksojmë se ekzistojnë të gjitha mundësitë për përdorimin e tyre tërësor (por jo me vlerën nominale) gjë që do të rriste reputacionin e qeverisë.

Së dyti, a ka programi i privatizimit në Shqipëri një element sado të vogël social? Mendojmë se në mënyrën e trajtimit të bonove të privatizimit ky element mungon. Pra, duhet të theksojmë se nga bonot e privatizimit përfituan vetëm grupe të caktuara duke u bazuar në lidhjet që kishin me qeverinë si dhe disa punonjës të ndërmarrjeve që u privatizuan (elementi rastësi).

Së treti, mendoni një situatë kur shteti mund të emetojë letra me vlerë për publikun. A mund të imagjinohet se qytetarët shqiptarë do të besojnë më tek letrat me vlerë?

Së katërti, privatizimi i 97 ndërmarrjeve në raundet e privatizimit masiv, duke përdorur thjeshtë vetëm bonot e privatizimit krijoi në vetvete një parakusht për një moseficiencë të këtyre ndërmarrjeve pas privatizimit. E themi këtë sepse së pari, blerësit e këtyre kompanive i morën ato pa paguar asgjë në *cash* (nënkupto gati si

të falura) dhe, nga ana tjetër, shumica e tyre nuk kishin as mundësinë më të vogël për investime kapitale në rinovimin teknologjik dhe shpesh as njohuritë e duhura administrative në kushtet e reja të biznesit. Mungesa totale e kapitalit të huaj në këtë proces është një element që flet qartë.

Nga ana tjetër, sot tingëllon absurd theksimi i bërë në strategjinë e privatizimit “Brenda vitit 1997 qeveria do të marrë në analizë fenomenin e krijuar nga emetimi i pabalancuar ligjërsh, ekonomikisht dhe pa kushte tregu të lekëve dhe të bonove të privatizimit, duke parashikuar masat për të kapërcyer gjendjen e rënduar”.

2. PROBLEME ADMINISTRATIVE TË PASPRIVATIZIMIT

Metoda e privatizimit masiv, që u përdor në Shqipëri, u bazua kryesisht në blerjet nga brenda (punëtor dhe drejtues) të ndërmarrjeve dhe rezultoi në një strukturë mjaft të shpërndarë pronësie. Punëtorët dhe ish-punëtorët janë prezent në më shumë se 80 për qind të ndërmarrjeve të privatizuara, ndërkohë që mungoi plotësisht angazhimi i institucioneve financiare në këtë proces. Mungesa e fondeve të investimit në këtë proces, që mund të angazhoheshin në emër të individëve të veçantë për monitorimin e drejtimit dhe për të influencuar në procesin e vendimmarrjes, i privoi këta individë nga ky shërbim i specializuar, një situatë kjo e Shqipërisë krejt ndryshe nga ç’ndodhi në Republikat Çeke e Sllovake dhe në Poloni.

Struktura e shpërndarë e pronësisë, që rezultoi nga kjo metodë, solli si rezultat një sjellje pasive dhe mungesë motivimi nga ana e drejtuesve për të ristrukturuar ndërmarrjet e tyre në periudhën e pasprivatizimit. Kështu, për 45 ndërmarrjet e marra në shqyrtim, indeksi i ristrukturimit rezultoi më i vogël se 2.5 (në një shkallë nga 1-minimumi deri në 5-maksimumi), duke demonstruar për përpjekje të pamjaftueshme nga ana e administratorëve për të transformuar ndërmarrjet. Ky indeks tregon se si mesatare masa e ristrukturimit të këtyre ndërmarrjeve pas privatizimit ka qenë e ulët, krahasuar me vendet e tjera në tranzicion. Për më tepër, kjo ndikon edhe mekanizimin e qeverisjes së ndërmarrjes, që nuk mund të funksionojë siç duhet: drejtuesit e ndërmarrjeve nuk kanë një motivim të madh për t’u angazhuar në ristrukturim të thellë, si rrjedhim, situata e pafavorshme vështirëson mjaft tërheqjen e kapitaleve të reja aq të nevojshme për këto ndërmarrje të privatizuara. Dhe rezultati final do të jetë: efekte negative në performancë.

Në këtë kuadër, vërehet një tendencë për të lëvizur drejt një strukture më të përqendruar pronësie në këto ndërmarrje. Nga studimi ynë rezulton se në vitet e pasprivatizimit ka ndodhur një përqendrim i pronësisë midis ndërmarrjeve me një numër të madh aksionerbajtësish, megjithëse numri i ndërmarrjeve me më shumë se 100 aksionerë është akoma i madh (46.7%) gjë që reflekton një strukturë akoma të shpërndarë. Ky përqendrim mund të shihet jo vetëm në numrin e aksionerëve, por edhe përsa i përket paketave të tyre të aksioneve. Kështu, paketa kontrolluese e aksioneve është përqendruar në duart e shumë pak pronarëve. Për më tepër, drejtuesit rezultojnë të jenë më të motivuar në ndërmarrjet me struktura të tilla të përqendruara të pronësisë. Është e rëndësishme të përmendim se për secilin nga aspektet e ristrukturimit (ristrukturimin e mjeteve, ristrukturimin e përdorimit të burimeve, ristrukturimin e strukturës drejtuese, riskstrukturimin e produktit dhe tregut të synuar dhe riskstrukturimin financiar) për struktura me pronësinë më të shpërndarë kemi edhe indekset më të vogla të ristrukturimit. Kjo karakteristikë e indeksit të ristrukturimit mund të shpjegohet me faktin se është më e thjeshtë për të arritur një marrëveshje kur një numër i vogël aksionerësh të interesave të ndryshme janë të përfshirë në proces.

Si rrjedhim, procesi i marrjes së vendimit është më i lehtë dhe më i shpejtë në kompanitë me strukturë të përqendruar pronësie dhe drejtuesit e tyre mund të marrin masa më radikale e strategjike ristrukturimi.

Gjithashtu, vëmë re se për secilin nga grupet e pronësisë (më pak se 20 aksionerë; 20 – 50 aksionerë; 50 – 100 aksionerë; dhe mbi 100 aksionerë) vlerat më të larta të indeksit të ristrukturimit janë ato që lidhen me punësimin dhe me aspektin e drejtimit, që tregojnë për përpjekje më të mëdha nga ana e administruesve në drejtim të transformimit struktural të ndërmarrjeve të tyre si dhe për një përdorim më eficient të lëndëve të para dhe të burimeve të tjera. Çështjet më problematike, që shihen si të lëna pas dore (ose të pamundura për t'u zgjidhur) nga ana e drejtuesve janë ato që lidhen me ristrukturimin e huave dhe të kredive, aspekt për të cilin kemi edhe indeksin më të ulët të ristrukturimit. Duke i përmbledhur rezultatet, mund të themi se nga pikëpamja e strukturës së pronësisë së rezultuar nga privatizimi masiv ka ndryshime të ndjeshme midis grupeve të ndryshme të ndërmarrjeve të anketuara, ku ndërmarrjet e dominuara nga një numër relativisht i

vogël pronarësh paraqiten edhe më mirë në të gjitha aspektet e ristrukturimit.

Anketimi përfshiu, gjithashtu, disa pyetje lidhur me ndryshimet në strukturën drejtuese në periudhën e pasprivatizimit. Kështu, evidenca tregon se rreth 67 për qind e ndërmarrjeve (30/45) kanë përjetuar disa ndryshime në strukturën drejtuese. Këto ndryshime lidhen me funksione të ndryshme drejtuese. Kështu, 68 për qind e ndërmarrjeve kishin bërë disa ndryshime si në strukturën e drejtimit financiar, ashtu edhe në atë të drejtimit të operacioneve dhe të prodhimit; 62 për qind kishin bërë disa ndryshime në strukturat e marketingut, të drejtimit dhe të kontrollit të cilësisë. Vetëm 33 për qind e ndërmarrjeve nuk patën përjetuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në strukturat e tyre drejtuese. Evidenca tregon se shumica e këtyre ndërmarrjeve të fundit kishin një strukturë pronësie të shpërndarë. Kështu, më shumë se 60 për qind e tyre kishin më shumë se 50 pronarë dhe vetëm 6.7 për qind e tyre kishin më pak se 20 pronarë. Rezultate këto që pak a shumë priteshin dhe që përkojnë me rezultatet e tjera në lidhje me këto çështje.

Si përfundim, eksperiencia e vendeve të tjera të tranzicionit në fushën e qeverisjes së ndërmarrjes sugjeron nevojën urgjente të përfshirjes së ndërmjetësve financiarë (të tillë si fondet e investimit) në procesin e privatizimit. Megjithëse rëndësia e përqendrimin të pronësisë është tashmë e pranuar edhe nga qeveria, akoma nuk ka (dhe ndoshta s'do të ketë asnjëherë) ndonjë evidencë konkrete të kuptimit të rolit potencial të fondeve të investimit si agjentët e qeverisjes dhe të ristrukturimit të ndërmarrjeve.

3. ADMINISTRIMI I PROCESIT

Problemi i qeverisjes së ndërmarrjes (*corporate governance*) është trajtuar dhe trajtohet gjithnjë kur ka një ndarje të dukshme midis pronësisë dhe administrimit, midis aksionerëve dhe administratorëve. Është e natyrshme që kjo ndarje shpesh vihet re edhe në rastin e pronës private, por duhet të theksojmë se në rastin e pronës shtetërore ka një ndarje mëse të qartë mes pronarit shtet dhe administratorëve të kompanive publike. Sipërmarrjet dhe bizneset duhet të jenë organizma ku pronësia të jetë e ndarë nga administrimi. Pronarët duhet të operojnë me tituj-pronë e tyre, ndërsa administratorët janë të përhershmit në biznes, janë ata që e drejtojnë atë.

Duke pasur parasysh kapacitetin ekzistues administrativ si dhe nivelin e zhvillimit të tregjeve dhe të institucioneve financiare, forma e privatizimit masiv e zbatuar në Shqipëri ishte mjaft e thjeshtë dhe e ndryshme nga vendet e tjera në tranzicion. Duke pasur parasysh edhe mungesën e kapitalit të brendshëm, kjo metodë e zbatuar në Shqipëri synoi një transformim të shpejtë dhe të barabartë të pronësisë me qëllimin edhe të rritjes së kredibilitetit të programeve të reformës dhe të shanseve të tyre për sukses. Shpejtësia do të mund të mënjanonte kundërshtimin e privatizimit nga ana e punonjësve dhe e grupeve të tjera të interesuara.

Por, pavarësisht nga shpejtësia relative e fillimit, mungesa e një plani të përgjithshëm të privatizimit ishte një nga të metat kryesore të programit. Natyra e tij *ad hoc*, që u zbatua nëpërmjet një sërë vendimesh të Këshillit të Ministrave, në vend të një ligji privatizimi, tregon për një vëmendje jo të plotë nga ana e hartuesve të politikave ndaj të gjitha implikimeve të privatizimit. Për më tepër, mosarritja e një konsensusi politik që në fillim, për programin e privatizimit si dhe ndryshimi mëvonshëm i strategjisë, tregojnë për një papërgjegjshmëri nga ana e klasës politike ndaj popullatës dhe kursimeve të tyre.

Mungesa e sinkronizimit midis shpërndarjes së bonove të privatizimit dhe zgjedhjes së kompanive për t'u privatizuar, solli një element të rëndësishëm pabarazie në sistemin që kishte si qëllim kryesor barazinë. Kështu, nëse kompanitë e privatizuara, në raundet e para, do të rezultonin të suksesshme, atëherë shtetasit, që deri në këtë moment nuk i kishin marrë akoma bonot e tyre, do të ishin të pafavorizuar nga procesi dhe anasjelltas. Mungesa që shoqëroi të gjithë procesin e listës së plotë të ndërmarrjeve që do të privatizoheshin, e vlerës totale të tyre si dhe e prospekteve dhe informacioneve të plota financiare për secilën prej tyre, e vuri akoma edhe më tepër në pikëpyetje drejtësinë dhe barazinë e programit. Madje, edhe në fund të vitit 1997, pra dy vjet pas fillimit të programit të privatizimit masiv, asnjëri nuk e dinte se cilat ndërmarrje do të përfshiheshin në program në të ardhmen.

Gjithashtu, skema nuk parashikonte ankandin apo ndonjë përpjekje tjetër për të gjetur vlerën e tregut të aksioneve të kompanive të ndryshme. Në vend të kësaj, u përdor vlera sipas librave kontabël të kompanive. Të gjithë blerësit merrnin aksionet e kompanisë për të cilën kishin zbatuar, në proporcion me numrin total të bonove të angazhuara për atë kompani të veçantë. Kështu, në rastin ekstrem, nëse do kishim vetëm një aplikues për aksionet e një kompanie të veçantë, ky aplikant do të mund të merrte të

gjitha aksionet disponibël, një implikim tjetër i rëndësishëm ky për barazinë e të gjithë procesit.

4. STRATEGJIA E RE DHE IMPLIKIMET E SAJ

Natyrshëm, që me ardhjen e forcave të majta në pushtet, u trumpetua me forcë strategjia e privatizimit. Megjithë difektet e saj në mënyrën se si u hartua, përsëri, mendojmë se problemet më të mëdha janë në zbatimin e saj. Po të studiohet strategjia do të vihet re se nuk janë respektuar aspak afatet kohore të caktuara për përgatitjen dhe privatizimin e ndërmarrjeve të ndryshme. Përse nuk ka një analizë të gjerë (bile edhe publike) të faktorëve që kanë sjellë mosrespektimin e kësaj strategjie të miratuar me ligj?

Gjithashtu, një problem tjetër i ndërhyrjes politike ka të bëjë me përcaktimin e rradhës së privatizimit në privatizimin strategjik, që është bërë dhe po bëhet thjesht mbi bazën e një administrimi më të mirë të mëparshëm të kompanisë që privatizohet, për të arritur kështu artificialisht, një privatizim të suksesshëm duke krijuar një imazh më të mirë rreth thithjes së investimeve të huaja, se sa në bazë të një analize ekonomike të mundësisë së krijimit të të gjitha kushteve për një operim normal në treg (eliminimi i pozitës monopol, mbështetja e tyre nga tregu i administratorëve dhe i specialistëve, krijimi i nxitësve të nevojshëm fiskalë, si dhe analiza e tregut të mundshëm të produktit ose të shërbimit të dhënë).

Luhatjet e shpeshta politike bëjnë që të mendohet më tepër për objektiva afatshkurtër dhe mbase afatmesëm se sa për objektiva afatgjatë. Gjithashtu, korelanca e tyre e lartë me korrupsionin qeveritar është një barrierë e rëndësishme ndaj një performance të mirë.

Le të marrim rastin e AMC. Askush nuk shpjegon pse u desh të propagandohej me të madhe se privatizimi ishte bërë nga një kompani norvegjeze (Telenor) dhe jo nga një kompani greke, duke rritur kështu edhe më tepër dyshimet e publikut se diçka jo e këndshme do të vinte më pas. Dhe realiteti tregoi se AMC po i grabit shqiptarët në dy drejtime:

1. Shërbim me cilësi mjaft të ulët.
2. Shërbim me tarifa mjaft të shtrenjta.

Strategjia vetëm teorikisht përmend "harmonizim në raporte të përshtatshme dhe përdorim të letrave me vlerë", sepse siç u theksua edhe më sipër, asgjë nuk është bërë në këtë drejtim.

Gjithashtu, theksimi i bërë në strategji se “Procesi i privatizimit do të synojë prishjen e këtyre strukturave (*monopol dhe oligo-monopol*) dhe rritjen e konkurrencës në tregun e brendshëm dhe, për sektorë të caktuar, hapjen e tyre ndaj konkurrencës së jashtme”, mendojmë se është një objektivi i paarritur dhe për të nuk është punuar.

Në të njëjtën kohë, realiteti i sotëm tregon dështim në arritjen e objektivit të shpallur në strategji se “... do të punohet për plotësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator për funksionimin e shoqërive anonime para dhe pas privatizimit, për përfshirjen në programin e privatizimit të shoqërive të tilla që do të përbënin shembuj pozitivë për tregun e kapitaleve, si dhe në bashkëpunim me Bursën e Tiranës për formalizimin e tregut të letrave me vlerë, si një parakusht për ta bërë këtë treg efikas e me likuiditet” .

5. E DREJTA E PRONËSISË, E DREJTA E ADMINISTRIMIT, DHE E ADMINISTRIMIT DHE E DREJTA E MONITORIMIT

Duke analizuar shoqëritë anonime shtetërore, që janë në procesin e privatizimit, vihet re se në Shqipëri nuk ka një dallim të qartë midis organizmave që ushtrojnë të drejtën e pronësisë, të drejtën e administrimit dhe të administrimit dhe të drejtën e monitorimit. Të gjithë këta organizma varen nga ministri i linjës. Le të përmendim këtu entet rregullatore të telekomunikacioneve dhe të energjisë etj.. A mund të ketë rezultate monitorimi kur ai varet nga i njëjti person që varen edhe aktivitetet që ata monitorojnë?

Nga ana tjetër, sa transparent është procesi i administrimit të kompanive publike kur bordet administruese përdoren thjesht si poste për të rritur të ardhurat e disa drejtuesve dikasterialë dhe të përkrahësve të forcave në pushtet. Nëse do të kërkosh të dhëna për përbërjen e bordeve administruese të kompanive publike, kjo gjë do të quhet herezi dhe studiuesi heretik.

6. ROLI I SHTETIT NË MONITORIMIN E MJEDISIT KONKURRUES

Është detyrë parësore e organeve shtetërore krijimi i mjedisit favorizues për konkurrencë të ndershme. Nëse konkurrenca e pandershme godet sipërmarrjet private, ajo godet, gjithashtu, bile edhe më fort, ndërmarrjet e privatizuara. Pa dashur të politizojmë problemin, sot është e vështirë të flitet për konkurrencë të ndershme në zhvillimin e bizneseve shqiptare dhe është po aq e vështirë që të flitet për eficiencë të privatizimit.

Gjithashtu, mendojmë se është një detyrë parësore e shtetit që të krijojë programe ndihme pas privatizimit. Kjo nuk do të thotë që shteti duhet të jetë mbështetësi kryesor i ndërmarrjeve të privatizuara, por, gjithësesi, për këto ndërmarrje duhet një kujdes i përkohshëm deri sa këto të marrin veten dhe të jenë të afta të përballen me konkurrencën e ndershme. Është një lloj si fëmija i vogël që ka nevojë për më shumë kujdes deri sa të hedhë hapat e parë.

Më mirë se sa të konsumojmë prodhime të importit, duke u bërë treg shitjeje për produktet e vendeve fqinje dhe duke rritur potencialin korruptiv të doganave dhe të administratës shtetërore, ne duhet të nxisim prodhimin vendas, duke krijuar vende të reja pune, si dhe mundësi jo vetëm për përmirësimin e strukturës së të ardhurave të buxhetit të shtetit por, edhe të vlerës absolute të këtyre të ardhurave.

7. PM DHE TREGJET E KAPITALIT

Rezultatet e studimit lidhur me mënyrat e financimit të ndërmarrjeve të privatizuara me bono privatizimi tregojnë se burimi kryesor i financimit ka qenë ai i brendshëm dhe pikërisht nëpërmjet fitimit të pashpërndarë, i cili ka qenë krejt i pamjaftueshëm për investime të reja. Kreditimi nga bankat i këtyre ndërmarrjeve është në nivele mjaft të ulta. Kështu, më shumë se 78 për qind e tyre nuk kanë pasur ndonjëherë ndonjë eksperiencë kredimarrjeje me bankat apo me institucionet e tjera jobankare. Ndër arsyet e përmendura vendin kryesor e zënë normat e larta të interesave, kolaterali i kërkuar si dhe procedurat komplekse të aplikimit. Gjithashtu, vetë bankat preferojnë më tepër të japin hua tregtare afatshkurtra, ndërkohë që gjendja e mjerueshme në të cilën ndodhen pajisjet dhe mjetet e tjera fikse të këtyre ndërmarrjeve kërkon më tepër hua afatgjata për financim. Ndërkohë që bashkëpunimi me të huajt, megjithëse mjaft i kërkuar nga ndërmarrjet e privatizuara, sidomos me qëllim rritjen e kapitalit dhe futjen e teknologjisë së re, pothuajse nuk ka ekzistuar fare për vetë kushtet politiko-ekonomike të pasvitit 1997.

E vetmja mënyrë e mbetur pa shqyrtuar është ajo nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja të zakonshme dhe ndoshta rritjes së numrit të pronarëve, mënyrë kjo, që për vetë stadin e zhvillimit të tregjeve të kapitalit në vendin tonë, mbetet realisht në nivelin e të pamundurës. Ligji nr. 8080 "Për letrat me vlerë" dhe rregulloret përkatëse të nxjerra nga Komisioni i Letrave me Vlerë, teorikisht

rregullojnë procedurat e emetimit të aksioneve të reja nga ana e shoqërive anonime me ofertë publike dhe private. Por, në nivelin praktik akoma nuk është evidentuar ndonjë rast ku ndonjë ndërmarrje (të gjitha ndërmarrjet e privatizuara me bono kanë statusin e shoqërive anonime) të emetojë aksione të reja. Kjo, ndoshta, është e lidhur ngushtë edhe me mungesën e një institucioni nënshkrimi (banke nënshkruese) që të dalë garant për aksionet e këtyre ndërmarrjeve dhe të sigurojë reklamimin dhe shitjen e tyre në treg. Bankat tregtare (ku ndërmarrjet kanë llogaritë e tyre) mund të luajnë vetëm rolin e një sporteli për shitjen e këtyre aksioneve të reja, por sigurisht që edhe në këtë mënyrë, në rastin më të mirë shpejtësia dhe efektiviteti i mbledhjes së fondeve do të linte shumë për të dëshiruar. Nga ana tjetër, ligji që rregullon aktivitetin, si dhe vetë natyra e biznesit të këtyre bankave sot, ndalon marrjen përsipër të kompetencave dhe përgjegjësisë të tjera në këtë drejtim (përgjegjësitë për nënshkrimin dhe për garantimin e shitjes). Pra, e thënë me pak fjalë, këto institucione nuk do të mund të luanin dot rolin e mirëfilltë të një tregu kapitalesh për sigurimin e burimeve të financimit. Praktikisht, një ofertë e tillë aksionesh të reja, do të ishte shumë e vështirë t'i drejtohej publikut të gjerë dhe do të mbetej në limitet e një oferte private, ku njohjet personale do të mbeteshin i vetmi burim për sigurimin e fondeve.

LITERATURA

1. CASE "Privatization in Post-Communist Countries" Volume I, Varshav, 1996.
2. Dobek, M. M., „Political Logic of privatisation: Lessons from Great Britain and Poland“, London 1993.
3. Frydman, R., Rapaczynski A., Earle J. S., et al. *The Privatization process in the Republics of the Former Soviet Union*. CEU Privatization Reports, Volume II, Central European University Press, 1993.
4. Mema, F. *„Privatizimi në Shqipëri: arritje, të meta, e ardhmja“* Monografi, Tiranë, Korik 1997.
5. Mema F. *„Post privatization in Albania: Success or Failure“*, Konferenca Ndërkombëtare "Integration and transformation in

Albania, Hungary and Macedonia" Bamberg, Gjermani, 5-7 July 2001.

6. OECD Proceedings "Corporate Governance, state-owned enterprises and privatization" OECD, 1997.

7. Popov V. „Investment, Restructuring and Performance in Transition Economies“ Magazine Communist economies & economic transformation, London, V. 11, No. 4, 1999.

8. Problems of Privatisation in Bulgaria (Edited by Schonfelder) Munchen, 1997.